



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1220_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2001_11_19**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **17.12.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit B.E. nga Prishtina me shifër të konsumatorit **DGL – 30993** ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 17.12.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori B.E. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kundërshton vendimin e DMK të ZRRE bazuar në padinë e Avokatit të Popullit për pagesën e faturave për katër komunat veriore të Kosovës. Në ankesë konsumatori ka theksuar se është edhe vendimi i Gjykatës, si dhe prej mediave jam informuar se nuk duhet të ngarkohet pjesa e komunave veriore në faturat të cilat paguajnë ne, si dhe edhe vendimi i ZRRE thekson se prej datës 30.11.2017 kostot e komunave veriore nuk janë pjesë e pagesave të pjesës tjetër. Konsumatori në ankesë ka theksuar se kërkon që të kompenzohet për pjesën që ka paguar kur ka qenë pjesë të faturave edhe kostot e katër komunave veriore.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se kundërshton vendimin e DMK të ZRRE bazuar në padinë e Avokatit të Popullit për pagesën e faturave për katër komunat veriore të Kosovës, Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkallës së parë është plotësisht i saktë dhe i bazuar në dispozita ligjore të legjislacionit primar të sektorit të energjisë dhe në dispozita të legjislacionit sekondar. Për më tepër ZRRE edhe njëherë ju informon se është agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës, e themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Ligji Nr.05/L-084 të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me nenet 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së



Kosovës. Funkcionet dhe detyrat e ZRRE janë të përcaktuara sipas Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, përkatësisht neni 4 paragrafi 4 dhe sipas ligjeve të tjera të sektorit të Energjisë (Ligjit Nr. 05/-081 për Energjinë dhe Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike), e të cilat ligje janë në përputhje të plotë me Pakon e Tretë të legjislacionit Evropian për energjinë. Duhet theksuar se, ZRRE konform nenit 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5. të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë që: *“të sigurojë se tarifat e rregulluara për aktivitete të energjisë janë të arsyeshme dhe të vendosura në bazë të një metodologjie tarifore të përshtatshme, të thjeshtë e të lehtë, duke e përfshirë sigurimin e tarifave për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, adekuate për ta mundësuar kryerjen e investimeve të domosdoshme në sisteme, në mënyrë që këto investime të garantojnë qëndrueshmëri të sistemeve”*. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ju informon se Aktvendimi i Gjykatës A. nr. 1373/2018 Themelore në Prishtinë i vërtetuar me Aktvendimin AA. Nr. 451/2017 ka të bëjë vetëm për shtyrje të ekzekutimit të vendimit V_399_2012, deri në vendosjen e çështjes meritore me Aktgjykim sipas kërkesëpadisë së paditësit Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, andaj ankesa juaj nuk mund të aprovohet. Për këtë ZRRE ju potencon se përderisa është duke u zhvilluar procedura administrativo–juridike, dhe deri sa nuk merret Aktgjykim i formës së prerë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative për çështjen meritore.

Bordi i ZRRE gjatë përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike me shërbime universale të furnizimit bazohet në dispozitat e nenit 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenit 15, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 25, nenit 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, nenit 46, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2, nenit 47 dhe nenit 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.05/L-084). Pra, dispozitat ligjore të cekura më lartë i japin kompetencë Bordit të ZRRE që të përcaktoj tarifat me pakicë të energjisë elektrike me shërbime universale. Sipas nenit 45 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, ZRRE trajton reflektimin e kostove në tarifat e furnizimit, ku theksohet se: *“në përcaktimin e tarifave të cilat do të mbledhen nga konsumatorët fundor për furnizimin e energjisë, ndërmarrja (licencuar nga ZRRE) energjisë do të siguroj që çmimet të cilat ngarkohen nga ajo, në cilëndo kohë, dhe për cilindo konsumator fundor për furnizimin e energjisë, të jenë të njëjta me çmimet të cilat janë ngarkuar nga ajo ndërmarrje e energjisë, në të njëjtën kohë për konsumatorët tjerë fundor për furnizimin e krahueshëm me energji... Këto tarifa do të reflektojnë plotësisht kostot e furnizimit të energjisë elektrike, për konsumatorët fundor nga ndërmarrja përkatëse e energjisë”*. Sipas nenit 47 të Ligjit për Rregullatorin për Energji është e obliguar të harton dhe miraton metodologji tarifore për përcaktimin e tarifave të rregulluara për furnizimin me energji. Gjatë procesit të përgatitjes të tarifave dhe metodologjive të tarifave, ZRRE në pajtim me Nenin 28 të këtij ligji bën konsultime publike, ku të gjitha palët e interesit kanë të drejtë të japin komentet e tyre gjatë procesit të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike dhe metodologjisë tarifore dhe se tek pastaj pas shqyrtimit të komenteve aprovohen tarifat me pakicë të energjisë elektrike dhe metodologjitë tarifore. Gjithashtu bazuar në nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, palët e pakënaqura vendimet e ZRRE në lidhje me tarifat e rregulluara apo metodologjitë e tarifave, mund t'i kontestojnë përmes inicimit të konfliktet administrative pranë gjykatës kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të Vendimit. Megjithatë në këtë dispozitë ligjore të ligjit të lartpërmendur theksohet se padia nuk e ndal ekzekutimin e vendimit të Bordit të ZRRE-së.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se është edhe vendimi i Gjykatës i cili ndalon ngarkimin e kostove të katër komunave veriore tek pjesa tjetër, Bordi i ZRRE ju thekson se është e saktë se Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës pas pranimit të Përgjigjes me shkrim nga ZRRE, me datë 15.08.2017 ka iniciuar Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative kundër Vendimit të Bordit të ZRRE-së, nr.V_399_2012 të datës 06.02.2012, me kërkesën/propozimin **për shtyrje të** ekzekutimit të vendimit, deri në vendosjen e çështjes kontestuese në mënyrë meritore. Gjithashtu Bordi i ZRRE ju thekson se



është e saktë se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me datë 11.09.2017 jashtë seance, ka vendosur vetëm për kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, dhe me Aktvendim A.nr.1373/2017 ka aprovuar kërkesën e paditësit – propozuesit Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës dhe ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të të paditurës ZRRE në Prishtinë, V_399_2012 të datës 06.02.2012, deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Për informimin e juaj ZRRE brenda afatit të rregullt ligjor ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës sipas nenit 23 dhe 49 lidhur me nenin 28 të Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.03 /L-202, me të cilën ka atakuar Aktvendimin e Gjykatës për shkaqet: shkeljet e dispozitave ligjore të LKA-së, shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative të Aprovoj ankesën e ZRRE si të bazuar dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative ta anuloj. Megjithatë Gjykata e Apelit të Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.10.2017 ka vendosur me Aktvendim me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ZRRE, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/2017 të datës 11.09.2017, e ka vërtetuar përkritazi me kërkesën/propozimin e paditësit Avokatit të Popullit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës Zyrës së Rregullatorit për Energji V_399_2012 të datës 06.02.2012, deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit në çështje meritore. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se ekziston Aktvendimi i gjykatës e cila ka të bëjë vetëm me shtyrje të ekzekutimit të vendimit V_399_2012 të datës 06.02.2012 dhe nuk është vendosur ende për çështje meritore.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se sipas vendimit të ZRRE prej datës 30.11.2017 kostot e komunave veriore nuk janë pjesë e pagesave të pjesës tjetër, Bordi i ZRRE-së thekson se sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A. Nr.1373/2017 të datës 11.09.2017 me të cilën është shtyrë ekzekutimi i Vendimit të ZRRE-së, V_399-2012 i datës 06.02.2012 deri në marrjen e Aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësi, Aktvendim i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me numër AA.nr.451/2017 të datës 20.10.2017, duke përfshirë periudhën nga data 01.12.2017, ka Udhëzuar KOSTT, KEDS dhe KESCO që të zbatojnë tarifën me pakicë, pas përshtatjes së të Hyrave Maksimale e mbështetur në vendim të Gjykatës, deri në një vendim i cili pritet të merret nga Bordi i ZRRE-së. Pra Bordi i ZRRE ka vepruar konform Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A. Nr.1373/2017 të datës 11.09.2017, respektivisht konform Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër AA.nr.451/2017 të datës 20.10.2017.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit lidhur me kërkesën për kompensim për pjesën që ka paguar konsumatori kur ka qenë pjesë të faturave edhe kostot e katër komunave veriore, Bordi i ZRRE-së thekson se aktualisht kostot e furnizimit të katër komunave veriore nuk janë pjesë e tarifave të energjisë, dhe kjo nga periudha 30.11.2017, dhe se Aktvendimi i Gjykatës A.nr.1373/2018 Themelore në Prishtinë i vërtetuar me Aktvendimin AA.Nr.451/2017 ka të bëjë vetëm për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Bordit të ZRRE-së V_399_2012, deri në vendosjen e çështjes meritore me Aktgjykim sipas kërkesëpadiës së paditësit Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, andaj bazuar në këtë ankesa juaj nuk mund të aprovohet. Për këtë, Bordi i ZRRE ju potencon se përderisa është duke u zhvilluar procedura administrativo–juridike, dhe deri sa nuk merret Aktgjykimi i formës së prerë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative për çështjen meritore, ZRRE konsideron se ankesa e juaj është e pabazë dhe si e tillë edhe duhet të refuzohet, andaj edhe vendimi i organit të shkallës së parë lidhur me refuzimin e ankesës suaj ka qenë i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i



drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke kërkuar kompensim.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit B.E.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.